



Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), lidhur me nenin 17, paragrafi 1, shkronja (b) dhe (c), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008” nenit 15, lidhur me nenet 28 dhe 29, pika 2 te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës së Suharekës në mbledhjen e mbajtur me datën, -----, miraton këtë:

Projekt-V E N D I M
Për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-16-4813, të datës 27.06.2013

Neni 1

Me këtë vendim ndryshohet-plotësohet vendimit, 01-Nr-16-4813 i datës 27.06.2013, për dhënien pëlqimit për këmbimin e pronës publike komunale me pronën private, me qëllim të korrigjimit-përmirësimit të numrave të parcelave dhe sipërfaqeve të pronave private dhe publike.

Neni 2

Nenit 1, të vendimit bazik me numër të protokollit 01-Nr-16-4813, të datës 27.06.2013, ndryshohet dhe riformulohet si vijon:

JEPET PËLQIMI- për këmbimin e pronës publike komunale me pronën private të cilat gjinden te vendi i quajtur “Fshat“, zona kadastrale Mushtisht: parcela, P-72116029-**03764-1**, me sipërfaqe të përgjithshme prej **1997m²**, nga sipërfaqja e përgjithshme jepen **191m²**, parcela P-72116029-**03764-2**, me sipërfaqja te përgjithshme prej **24m²**, parcela, P-72116029-**03008-1**, me sipërfaqe të përgjithshme prej **1004m²**, nga sipërfaqja e përgjithshme jepen **53m²**, parcela, P-72116029-**03008-2**, me sipërfaqe të përgjithshme prej **4m²** dhe parcela, P-72116029-**03008-3**, me sipërfaqe të përgjithshme prej **20m²**, nga sipërfaqja e përgjithshme jepen **14m²**, që të gjitha P.Sh. “Rrugë publike e pakategorizuar”, **Ju jepen** bashkëpronarëve; Hisen Bajram Durmishi, Ali Bajram Durmishi dhe Jeton Ismet Durmishi, që të tret nga fshati Mushtisht, **ndërsa**: parcela, P-72116029-**03011-5**, me sipërfaqe të përgjithshme prej **29m²**, në emër të Jeton Ismet Durmishi, parcela, P-72116029-**03012-2**, me sipërfaqe prej **32m²** parcela P-72116029-**02845-1**, me sipërfaqe prej **211m²** dhe parcela P-72116029-**02845-3**, me sipërfaqe prej **14m²**, në emër të bashkëpronarëve: Hisen Bajram Durmishi, Ali Bajram Durmishi dhe Jeton Ismet Durmishi, që të tret nga fshati Mushtisht, **I jepen** Komunës së Suharekës, në emër të këmbimit, për rregullimin e infrastrukturës rrugore, për interes të përgjithshëm publik.

Neni 3

Ndërsa pjesët tjera kompletë të vendimit bazë me numër 01-Nr-16-4813 i datës 27.06.2013, mbesin të pa ndryshuara.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

K U V E N D I I K O M U N Ë S N Ë S U H A R E K Ë

01-Nr-_____
Më datë_____

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI